

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA- VLADA-GOVERNMENT	
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE	
Ministarstvo Rradë - Sektorine Zastita - Ministry of Labour and Social Welfare	
Sektori Arkivi - Sektor Archive-Archive Sector	
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.: <u>296</u>	Data: Datum: Dafe: <u>26, 06, 19</u>
Org. Unit: Org. Unit: Org. Unit: No. pages: <u>04</u>	Prishtinë-Prishtina-Prishtina



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDIT SIGURIMIT SHËNDETËSOR- FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE	
HEALTH INSURANCE FUND	
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.: <u>1390</u>	Data: Datum: Dafe: <u>26 06 19</u>
Org. Unit: Org. Unit: Org. Unit: No. pages: <u>4</u>	Prishtinë - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**

*Republika Kosovo – Republic of Kosovo*

Qeveria – Vlada – Government

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**FONDIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE**

dhe

**MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**PASI QË**, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëtejshëm: 'FSSH') dhe Agjencia e Regjistrimit Civil (në tekstin e mëtejshëm "MPMS") janë dakorduar për këtë Memorandum Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejshëm 'Memorandumi').

**DUKE QENË SE**, FSSH dhe MPMS (më tej referohen bashkërisht si "palët") kanë qëllime të ngjashme në sigurimin e kushteve më të mira për jetesë dhe zvogëlimin e varfërisë si dhe në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe kualitative të qytetarëve të Republikës së Kosovës;

**SI RRJEDHOJË**, palët kanë rënë dakord të thellojnë bashkëpunimin e tyre në bazë të këtij memorandumi bashkëpunimi dhe të vendosin kornizat e bashkëpunimit për zbatimin e plotë të këtij Memorandumi.

## **1. QËLLIMI**

- 1.1 Qëllimi i Memorandumit të tanishëm është të lehtësojë bashkëpunimin në mes të Palëve në çështjet me interes të përbashkët dhe me theks të veçantë në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Sistemit Informativ të FSSH-së ("SIF") dhe sistemeve informative të MPMS-së.
- 1.2 Ky memorandum përcakton kushtet nën të cilat palët mundësojnë shkëmbimin e informatave nga sistemet përkatëse të tyre.

## **2. PËRDORIMI I TË DHËNAVE**

- 2.1 Përdorimi i të dhënave do të mundësohet përmes leximit të tyre (marrjes), përmes Ueb Shërbimeve (ose Ueb API-ve) dhe do të jenë të qasshme vetëm nga përdorues të autorizuar.
- 2.2 Palët mund të hartojnë udhëzues (procedura) për shkëmbimin e të dhënave përmes të cilëve do të definohet lloji i të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik të informatave.

## **3. ZOTIMET E FSSH-së**

- 3.1. FSSH do të sigurojë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.
- 3.2. FSSH zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 3.3. FSSH zotohet që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e saj të i nënshtrohen mekanizimeve të sigurisë dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandumi dhe të njëjtat do të jenë të qasshme vetëm nga palët e autorizuara.

#### **4. ZOTIMET E MPMS-së**

- 4.1. MPMS do të sigurojë teknologjinë e duhur që do të shfrytëzohet si urë lidhëse ndërmjet sistemeve.
- 4.2. MPMS zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 4.3. MPMS pajtohet që të dhënat që janë në pronësi apo më të cilat disponon në lidhje me skemat sociale dhe testin e varfërisë të i vë në dispozicion të FSSH-së së paku një (1) herë në muaj, përmes qasjes në bazat e saj të të dhënave.
- 4.4. MPMS zotohet të njoftojë pa vonesë FSSH-në në rast të ndryshimi të çfarëdo të dhëne të kërkuar si më lartë të secilit qytetar / shtetas të Republikës së Kosovës.

#### **5. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

- 5.1 Të dhënat që shkëmbehen në mes të MPMS dhe FSSH nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar.
- 5.2 Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **6. AFATI, NDËRPRERJA, AMANDAMENTIMI**

- 6.1 Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga të dy Palët dhe do të mbetet i vlefshëm për afat të pacaktuar.
- 6.2 Ky Memorandum mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të Palëve. Palët mundën, me shkëmbim letrash, të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e këtij Memorandumi ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të disenjuara për të përcaktuar më tej fushëveprimin e këtij Memorandumi.

#### **7. MARRËDHËNIET E PALËVE**

- 7.1 Për qëllimet e këtij Memorandumi, çdo Palë është Kontraktuese e pavarur. Asnjë Palë nuk do të ketë autorizime për të bërë ndonjë deklaratë, përfaqësim ose angazhim të çfarëdo lloji, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim i cili do të jetë detyrues për Palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht në këtë Memorandum ose të autorizuar me shkrim nga Pala tjetër.

#### **8. PËRGJEGJËSIA**

- 8.1 Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të këtij Memorandumi dhe / ose ndonjë marrëveshje tjetër. Kështu që, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim i është shkaktuar ose e ka shkaktuar Pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentët ose nën-kontraktorët e Palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi.

## 9. HYRJA NË FUQI


- 9.1 Palët pajtohen që ky Memorandum fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit nga ana e tyre.
- 9.2 Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, palët obligohen në zbatimin e plote të këtij Memorandumi.

Për: Fondin e Sigurimeve Shëndetësore


Për: Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies  
Sociale

Fatmir Plakiqi,  
Drejtore

Izedin Bytyqi,  
Sekretari i Përgjithshëm



---



---

Prishtinë,

26 qershor 2019